

V E N D I M
Nr. 94, datë 4.2.1998

PËR SIGURIMIN E INFORMACIONIT NË TREGUN E PUNËS

Në mbështetje të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, me propozimin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas, nëpërmjet Drejtorisë së Statistikës dhe Informacionit, mbledh dhe përpunon informacion statistikor në fushën e tregut të punës e të mbrojtjes sociale dhe e përdor atë për të bërë analizën dhe parashikimin e tregut të punës, si dhe për të hartuar e orientuar drejt politikat e saj sociale.

2. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas, për të mbledhur këtë informacion, bashkëpunon me ministrinë e tjera, Sekretariatën Shtetërore për Pushtetin Lokal, Institutin e Statistikës, institucionet e tjera qendrore, si dhe me Shërbimin Kombëtar të Punësimit, Administratën e Përgjithshme të Çështjeve Sociale, Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës.

Për këto detyrohen:

-Të gjitha ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, si dhe organet e pushtetit lokal, sipas ligjit nr. 7687, datë 16.3.1993 “Për statistikën”, të japin informacion në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas për treguesit statistikorë të tregut të punës dhe prirjet e zhvillimeve të këtij tregu për fushat që ato mbulojnë.

-Të gjitha fondacionet vendase ose të huaja, të cilat financojnë projekte vetëpunësuese, të japin informacion në zyrën e punësimit për numrin e të punësuarve që përfitojnë vende pune nëpërmjet këtyre projekteve.

-Të gjitha subjektet private të japin informacion në zyrën e punësimit për numrin e të punësuarve dhe vendet e lira të punës. Zyrat e punësimit detyrohen të mbajnë në fshehtësi informacionin e marrë nga çdo subjekt privat dhe ta përdorin atë vetëm në formë të përmbledhur, pa zbuluar të dhënat e biznesit të punëdhënësit.

-Të vendoset bashkëpunimi dhe bashkëveprimi ndërmjet organeve të nivelit lokal (zyrat e punës, seksionet e ndihmës ekonomike në bashki e komuna, zyrat e statistikës në rrethe, degët e sigurimeve shoqërore), të cilat marrin dhe përdorin informacion për tregun e punës, për shkëmbimin e këtij informacioni.

3. Informacioni për tregun e punës të jepet periodikisht gjatë vitit dhe domosdoshmërisht në fund të çdo tremujori. Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas përcakton periodicitetin dhe afatet e dhënies së këtij informacioni.

4. Parashikimi i tregut të punës kryhet në nivel lokal dhe atë kombëtar për:

-përshkrimin e gjendjes së tregut të punës në rrethana konkrete;

-parashikimin e zhvillimeve të tregut të punës për periudhat pasardhëse sipas tabelave të bashkëngjitura. Miratimi i tabelave dhe ndryshimet e tyre janë kompetencë e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas.

5. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas u dërgon ministrive, institucioneve të tjera qendrore dhe organeve të pushtetit lokal informacion për parashikimin e tregut të punës në shkallë kombëtare.

6. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas të nxjerrë udhëzimet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

7. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 296, datë 5.6.1995 “Për parashikimin afatshkurtër të tregut të punës” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

